



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

N.SH. "Televizioni 3 TV"
Pronare: Valbona Berisha
3 TV
OSHP46
Rr/Bregu I Diellit II, Blloku 39, nr 18
Prishtinë

URDHËR: LIC/KPM-2013/19
Ref: 1306/740/LIC/ni

URDHËR

*për revokim dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së Ofruesit të Shërbimeve Programore 3TV,
Prishtinë*

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. OSHP 3TV është ofrues i shërbimeve programore(OSHP) i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për të ofruar programe përmes rrjetit kabllor, në pajtim me rregulloren CIMC 2007/04. OSHP 3TV është pajisur me licencë të KPM-së, më datën 15 dhjetor 2010.
3. Më datën 20 dhjetor 2012, KPM është njoftuar zyrtarisht me shkrim nga OSHP 3TV, se heqë dorë nga licenca për ofrimin e shërbimeve programore.
4. Përmes të njëjtës shkresë, OSHP 3TV, ka njoftuar KPM-në se për shkaqe financiar heqë dorë nga licenca e KPM-së.

Arsyetimi


5. Me njoftimin e OSHP 3TV, që në mënyrë vullnetare heqë dorë nga licenca e ofruesit të shërbimeve programore, KPM, në pajtueshmëri me Nenin 7.1 të Udhëzuesit të KPM-së në Zbatimin e Sanksioneve ndaj të Licencuarve i cili thotë:

i. *“Një i Licencuar që vullnetarisht përfundon operimet e tij dhe njofton për këtë KPM-në do të konsiderohet se vullnetarisht e ka dorëzuar licencën e tij. Me të marrë një njoftim të tillë KPM-ja do ta konsideroj licencën të jetë e pavlefshme dhe të anuluar. Personeli i KPM-së do ta këshilloj Komisionin, i cili do ta lëshoj një Urdhër për Revokim të licencës pa paragjykuar në ndonjë aplikacion të ardhshëm për licencë të cilin i licencuari mund ta paraqes”.*

6. lëshon urdhër për revokim dhe shpallje të pavlefshme të licencës për OSHP 3TV.

URDHËR

7. Komisioni i Pavarur për Media, lëshon këtë Urdhër për Revokim të Licencës se OSHP 3 TV, përmes të cilit e konsideron të pavlefshme licencën për ofrimin e shërbimeve programore të OSHP 3TV që nga data e njoftimit nga përfaqësuesi i OSHP 3TV.


Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media



6 gershor 2013
datë